

*Biznesin ndërkombëtar e përbëjnë të gjithë transaksionet e biznesit në të cilat janë të kyçura ndërmarrjet e dy ose më shumë vendeve. Kompanitë merren me prodhimet e tyre, me çka ulin rrezikun nga mospajtimi në treg. Dëshira e njeriut për të ardhur të një sasi më të madhe dhe më cilësore e prodhimeve imponoi nevojën për ndarjen e punës. Ndarja e parë e punës kur nga bujqësia u nda blegtoaria, ndarja e dytë e punës kur nga bujqësia u nda zeytaria. Ndarja e tretë e punës paraqitet kur ndahet tregtia nga bankierit, ndërsa më vonë edhe nga komunikacioni. Ekzistojnë faktorë të ndryshëm të cilët kontribuojnë të realizohet ndarja e punës në korniza ndërkombëtare. Këto mund të grupohen në disa grupe, edhe atë: madhësitë e ndryshme të vendeve, niveli i zhvillimit të vendeve, kombinimi i ndryshëm i faktorëve të prodhimit etj. Biznesi ndërkombëtar i cili është i organizuar jashtë kufijve nacional është i determinuar nga faktorë të shumtë. Determinantat kryesore të zhvillimit global të biznesit ndërkombëtar janë: a) niveli i zhvillimit dhe madhësia e tregut vendor; b) sistemi i tregtisë ndërkombëtare; c) ndikimi i paqes globale; ç) rritja ekonomike e vendeve të caktuara; d) zhvillimi i teknologjisë së komunikimit dhe transportit; dh) krijimi dhe zhvillimi i kompanive multinacionale etj. Ndërmarrja për t'u zhvilluar në mënyrë të suksesshme në raportet ndërkombëtare, e nevojitet që menaxhmenti t'i njoh dhe kuptojë faktorët e rrethimit ndërkombëtar i cili ndikon në punën e ndërmarrjes si njësi, por edhe në ekonominë në tërësi. Faktorët kryesor të rrethimit të përgjithshëm ndërkombëtarë janë: faktorët ekonomik, faktorët politik, faktorët ligjor dhe faktorët socio-kulturor. Në praktikë shpesh shfrytëzohen pesë kanale përmes së cilës ndërmarrjet e realizojnë aktivitetin e tyre në biznesin ndërkombëtar, duke ndërhyrë në tregjet e shteteve të tjera. Ato janë: eksporti të të mirave dhe shërbimeve, shitja e licencave, franshiza, investime përbashkëta dhe investime direkte. Për të mundësuar rritje stabile dhe zhvillim të ndërmarrjes, menaxherët duhet të tentojnë ta rrisin efektin dhe efikasitetin e tyre në treg. Atë mund ta arrijnë nëse e zgjerojnë biznesin jo vetëm në tregun vendor, por edhe në tregun ndërkombëtar. Biznesi ndërkombëtar ka ndikim pozitiv jo vetëm në zhvillimin e ndërmarrjes si njësi, por edhe për zhvillimin*

Te lexohet me vemendje njesia dhe do ti pergjigjini pyetjet

1.Çka paraqet biznesi?

2.Cilet jane determinantat kryesore te biznesit numero?

3.Cilet jane kanalet qe shfrytezohen per te realizuar aktivitetin e biznesit?

4.Faktoret kryesore te rrethimit te pergjithshem cilet jane numero?